



Periodik mujor

Nr. 168

Maj 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raporton
në Komisionin për Ekonominë dhe Financat**

03

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar- Prill 2023

05

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

06-13

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

14-16

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2022 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat



Tiranë, 30 maj 2023 – Prezantohet Raporti Vjetor 2022 i AMF- së

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Mete prezantoi sot, më 30 maj 2023, në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, Raportin Vjetor të AMF për vitin 2022. Z. Mete bëri një pasqyrim të zhvillimeve kryesore të vitit të kaluar, si edhe paraqiti disa nga drejtimet kryesore ku do të përqendrohet veprimtaria e Autoritetit për periudhën në vazhdim.

Në fillim të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se viti 2022 ka pasur zhvillime të rëndësishme në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, si edhe në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Gjatë takimeve Bilaterale, ekspertët e Komisionit Evropian vlerësuan progresin e bërë në kuadër të përafrimit me Direktivat Evropiane dhe angazhimet e marra për plotësimin e rekomandimeve në Kapitullin 9, të drejtuar nga Autoriteti.

Më tej, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv evidentoi avancimin domethënës të Autoritetit në vlerësimin e bërë nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Në raportin e grupit të vlerësimit, rezulton se niveli i përputhshmërisë është rritur në 77.9%, krahasuar me 47.4% që ishte mesatarisht në vlerësimin e fundit që është bërë nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në vitin 2014. Në vitin 2022, AMF u bë rregullatori i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që aderon në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IAIS për shkëmbim informacioni dhe mbikëqyrje efektive në sigurime.

Vijon ...

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2022 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat

...vijon

Sa i përket ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, z. Mete u shpreh se në fund të vitit 2022, në tregun e sigurimeve, dëmet e paguara në numër ishin në nivelin më të lartë historik. Pagesat e dëmeve sollën një ulje të ndjeshme të numrit të dëmeve pezull, të cilat arritën në 13.4% të gjithë dëmeve të trajtuara nga shoqëritë e sigurimit, shifra më e ulët historike. Referuar impaktit të ligjit të ri të sigurimit të detyrueshëm motorik, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv përmendi uljen e mëtejshme të komisioneve të ndërmjetësimit deri në një mesatare prej 16%, daljen e Byrosë së Sigurimeve nga monitorimi 10-vjeçar i Këshillit të Byrove, kryesisht si pasojë e përmirësimeve ligjore, pagesën e dëmeve Fond Kompensimi në rreth 87% të rasteve përmes siguruesit të drejtpërdrejtë me procedura më të përshpejtuara, si edhe përdorimin në rreth 23% të rasteve të dëmeve të Raportit Evropian të Aksidenteve.

Në lidhje me zhvillimet në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u shpreh se të dhënat e muajve të parë të vitit 2023 tregojnë se fondet e investimit i janë rikthyer rritjes, pas ndikimeve të vitit të kaluar, të ardhura kryesisht si pasojë e zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare dhe rritjes së normës bazë të interesit. Investimet u orientuan drejt titujve të Qeverisë, ku gjatë vitit 2022 blerjet e individëve arritën në 49.6 miliardë lekë, me një rritje rekord prej 216% krahasuar me një vit më pare.

Në tregjet e kapitalit, z. Mete veçoi emetimin e parë me ofertë publike të një shoqërie tregtare në Bursë si një moment të rëndësishëm, i cili mund t'i hapë rrugën edhe emetimeve të tjera në të ardhmen. Zgjerimi i shërbimeve të investimit të subjekteve që operojnë në tregun e kapitaleve, si edhe rritja e mëtejshme e emetimit të obligacioneve me ofertë private janë sinjale pozitive për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu.

Në fund të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv përmendi disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit përgjatë këtij viti dhe në vazhdim, bazuar edhe në strategjinë 5-vjeçare të AMF, me fokus përafrimin ligjor me kuadrin evropian, ndërmarrjen e nismave në kuadër të financave të gjelbra, avancimin e mëtejshëm në standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në mbikëqyrje, etj.



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Prill 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar-prill 2023 kapën vlerën 6,819 milionë lekë, ose 16.75% më shumë se në janar-prill 2022. Gjatë muajit janar-prill 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 384,225 me një rritje prej 14.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.67% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.31% dhe risigurimi 0.021%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 46.69% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 53.31% të totalit të tregut.

Gjatë muajit janar-prill 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,108 milionë lekë, ose 3.26% më pak se në muajin janar-prill 2022, kryesisht ndikuar nga efektet e dëmeve në sigurimin e pronës.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për muajin janar-prill 2023 kapën vlerën 1,533 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 9.83% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Prill 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë muajit janar-prill 2023 arritën rreth 3,636 milionë lekë, ose 9.06% më shumë se në muajin janar-prill 2022.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizon tryezë diskutimi për zhvillimin e tregjeve të kapitalit

Dokumenti analizon situatën e tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe infrastrukturën e tij, duke propozuar ndërmarrjen e planeve konkrete të veprimit për zhvillimin e tregut të kapitaleve përgjatë një periudhe 5-vjeçare.



Tiranë, 26 maj 2023 – Tryezë “Mbi zhvillimin e tregjeve të kapitalit”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një tryezë diskutimi “Mbi zhvillimin e tregjeve të kapitalit”, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Dokumentit të Politikave “Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”. Të pranishëm në këtë tryezë ishin Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF, z. Ervin Mete, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zj. Delina Ibrahimaj, Zv.Guvernatorja e parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, drejtues të bankave tregtare, fondeve të investimeve, Bursës, si edhe aktorë të tjerë të tregjeve të kapitalit.

Në fjalën e mbajtur, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u ndal te rëndësia e zhvillimit të tregjeve të kapitalit si burim potencial ende i pashfrytëzuar për diversifikimin e alternativave të investimit, si edhe të mundësive të financimit. Z. Mete u shpreh se Dokumenti i Politikave është një strategji për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, me objektiva konkrete, i cili kërkon ndërveprimin e të gjithë aktorëve me rol kyç, si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, si edhe operatorët e tregut.

Objektivat kryesorë strategjikë të dokumentit janë: rritja e pjesëmarrjes së emetuesve, listimi i kompanive me kapital shtetëror, zgjerimi i bazës së investitorit dhe zgjerimi i gamës së instrumenteve financiare, siç janë instrumentet e gjelbra (green), eficienta dhe transparenca e tregut të kapitaleve, si edhe zhvillimi i tregut sekondar të Titujve. Dokumenti analizon situatën e tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe infrastrukturën e tij, duke propozuar ndërmarrjen e planeve konkrete të veprimit për zhvillimin e tregut të kapitaleve përgjatë një periudhe 5-vjeçare.

Vijon ...

AMF organizon tryezë diskutimi për zhvillimin e tregjeve të kapitalit

... Vijon

Ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat harmonizojnë legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Evropian, kanë përmirësuar ndjeshëm kuadrin e nevojshëm ligjor, plotësuar tashmë me të gjitha aktet e nevojshme nënligjore. Kuadri ligjor, në linjë me Direktivat Evropiane, si edhe plotësimi tërësor i infrastrukturës së tregtimit dhe pastregtimit, kanë krijuar të gjitha kushtet për zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve të kapitalit. Ligjet e reja kanë zgjeruar alternativat e investimit, mundësitë e ndërlidhjes me tregjet globale, si edhe ofrimin e një game të gjerë të instrumenteve financiare - theksoi Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Miratimi i ofertës së parë publike është një moment shumë i rëndësishëm për tregun shqiptar të kapitalit, i cili duhet të shërbejë si një sinjal për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Kjo është hera e parë që titujt e një shoqërie i ofrohen publikut të gjerë, duke shtuar kështu alternativat e investimit për investitorin shqiptar, si edhe mundësitë për sigurimin e aksesit në kapital për biznesin vendas – u shpreh z. Mete.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv foli për ecurinë e fondeve të investimit, të cilat pas rënies së vlerës së aseteve, si pasojë e efekteve të tregjeve ndërkombëtare dhe rritjes së normave të interesit në vitin 2022, i janë rikthyer rritjes në 3-mujorin e parë të vitit 2023. Ai theksoi se nga monitorimi i treguesve të likuiditetit, ashtu siç u theksua edhe në raportin e fundit të FMN, rezultoi se të gjitha fondet kanë qënë në përputhje më kërkesat rregullative, si edhe në asnjë rast nuk u cënua stabiliteti financiar.

AMF organizon trajnim me vlerësuesit e dëmeve në sigurime



Tiranë, 24 maj 2023 – Trajnim për vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në datat 24 dhe 29 maj 2023 sesione trajnimi me vlerësuesit e dëmeve në sigurime. Në këtë trajnim morën pjesë 120 persona, profesionistët të cilët ushtrojnë veprimtarinë si vlerësues dëmsh në sigurime dhe zbatojnë programin edukim në vazhdim si dhe individët të cilët janë të interesuar për të filluar një karrierë si vlerësues dëmsh në sigurime dhe ndjekin kualifikimin profesional.

Tematikat kryesore të programit të trajnimit ishin: (i) Njohja e parimeve themelore sipas Direktivës 2009/103/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës; (ii) Përvetësimi i kuadrit ligjor lidhur me trajtimin dhe llogaritjen e dëmshpërblimit; (iii) Përvetësimi i njohurive lidhur me sistemin e Kartonit Jeshil si dhe trajtimin e dëmeve; (iv) Njohja me kuadrin ligjor për licencimin dhe mbikëqyrjen e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, etj. Pjesëmarrësit në trajnim u njohën gjithashtu me kompetencat, kualifikimet dhe detyrimet që burojnë nga Ligji 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" për vlerësuesit e dëmeve në sigurime, si edhe u informuan mbi procedurat dhe afatet e trajtimit të ankesave, nga ana e shoqërive të sigurimit.

Ky trajnim zhvillohet në funksion të rritjes së nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorit, zgjerimit të njohurive të profesionistëve të fushës, si edhe rritjes së edukimit financiar për tregjet nën mbikëqyrje.



Roli i ESMA-s në mundësimin e kalimit në një ekonomi me karbon të ulët

**Fjalimi në Konferencën e Dytë Vjetore të Financave të Qëndrueshme
4 maj 2023**

**Natasha Cazenave
Drejtore Ekzekutive, ESMA**

Marrë me shkurtime dhe redaktim

Në diskutimin tim sot dua të shpjegoj atë që ne, në ESMA, Autoriteti Evropian i Tregjeve të Letrave me Vlerë, po përpiqemi të bëjmë për të kontribuar në tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët. Natyrisht, ne jemi vetëm një pjesë e sistemit dhe shumë varet nga niveli politik si dhe nga veprimet konkrete të ndërmarra nga kompanitë dhe pjesëmarrësit e tregut në terren. Por ESMA është e përkushtuar të bëjë pjesën e saj për të mbështetur tranzicionin e BE-së drejt një ekonomie më të qëndrueshme duke ndihmuar në ruajtjen e besimit në sistemin financiar, duke siguruar që investitorët të kenë informacionin e duhur për të marrë vendime të informuara për investime dhe se ekzistojnë masat e duhura për të mbrojtur integritetin e tregjeve tona dhe të parandalojmë rrezikun e greenwashing.

Së pari, le të bëjmë një hap prapa dhe të kujtojmë se kur filloi në BE ky rrugëtim për të përshtatur rregullat tona financiare me tranzicionin. Shtylla kryesore ishte Plani i Veprimit për Financimin e Rritjes së Qëndrueshme që Komisioni Evropian filloi në mars 2018. Ai përmbante një paketë ambicioze masash legislative për të nxitur sektorin financiar të mbështeste tranzicionin drejt një ekonomie më të qëndrueshme. Veprimet kryesore legislative që rrjedhin nga ai plan ishin Rregullorja e Taksonomisë, Rregullorja për Zbulimin e Financave të Qëndrueshme (SFDR) dhe rishikimet e Rregullores së Standardeve (BMR). Përveç kësaj, kërkesat rreth shpërndarjes së produkteve të investimit u ndryshuan (përmes MiFID II Niveli 2) dhe u iniciuan iniciativa të tjera, p.sh., standardi i BE-së për Bondin e Gjelbër. ESMA ka kontribuar aktivisht në këto zhvillime legislative që nga publikimi i Planit të Veprimit.

Vijon ...

**Fjalimi në Konferencën e Dytë Vjetore të Financave të Qëndrueshme
4 maj 2023
Natasha Cazenave
Drejtore Ekzekutive, ESMA**

Marrë me shkurtime dhe redaktim

... vijon

Që nga viti 2018, iniciativa të tjera kryesore kanë ndjekur si Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, Strategjia e Përtërirë e Komisionit për Financat e Qëndrueshme ose “Paketa Fit for 55”.

Ndërsa iniciativat si Marrëveshja e Gjelbër Evropiane shkojnë shumë përtej kompetencave të financave dhe mbulojnë veprime në të gjithë sektorët e ekonomisë reale për të nxitur një të drejtë dhe një tranzicion gjithëpërfshirës, rregullatorët financiarë kanë një rol të madh për të luajtur, i cili është të sigurojnë kornizën e shëndoshë për të mundësuar dhe lehtësuar financimin e tranzicionit.

Për më tepër, për të strukturuar kontributin tonë dhe për të ndihmuar në fokusimin e përpjekjeve tona në fushat me prioritet të lartë, ESMA ka zhvilluar Udhërrëfyesin e saj të Financave të Qëndrueshme që përcakton tre prioritete:

- Promovimi i transparencës dhe trajtimi i greenwashing;
- Ngritja e kapaciteteve, d.m.th., rritja e njohurive dhe ekspertizës së stafit të ESMA-s dhe Autoriteteve Kompetente Kombëtare;
- Monitorimi dhe vlerësimi i tregjeve dhe rreziqeve të ESG.

Në fund të fundit, këto veprime duhet të ndihmojnë në ruajtjen e besimit në sistemin financiar dhe janë në përputhje me prioritetet strategjike të ESMA-s për të nxitur tregje efektive dhe stabilitet financiar dhe për të rritur mbrojtjen e investitorëve me pakicë.

Sot do të doja të fokusohesha kryesisht në objektivin e parë dhe të gjithë punën që është bërë për të mbështetur ofrimin në treg të informacionit me cilësi të lartë: (i) nga korporatat mbi rreziqet mjedisore dhe sociale me të cilat përballen, si dhe mbi mënyrën se si ndikojnë aktivitetet e tyre në mjedis dhe tek aktorët e tjerë; (ii) nga pjesëmarrësit e tregut financiar në profilin e tyre të qëndrueshmërisë dhe veçoritë ESG të produkteve të investimit. Së fundi, do të doja të diskutoja se çfarë mund të bëhet më shumë për të lehtësuar vendimet e investimit të informuara dhe kanalizimin e shëndoshë të fondeve për të mbështetur një tranzicion të rregullt duke parandaluar greenwashing.

...

**Fjalimi në Konferencën e Dytë Vjetore të Financave të Qëndrueshme
4 maj 2023
Natasha Cazenave
Drejtore Ekzekutive, ESMA**

Marrë me shkurtime dhe redaktim

... vijon

- Raportimi i përmirësuar i qëndrueshmërisë së korporatave është gurthemeli i kornizës së financimit të qëndrueshëm
- Përmirësimi i kuadrit të dhënies së informacionit për subjektet financiare dhe produktet e investimeve
- Etiketat, këshillat dhe parandalimi i greenwashing
- Luftimi i greenwashing

...

Konkluzionet përfundimtare

Urgjenca e situatës kërkon veprim të shpejtë. Shumat e kapitalit të nevojshëm për financimin e tranzicionit janë të rëndësishme: Komisioni Evropian vlerësoi nevojat mesatare vjetore të investimeve për të reduktuar me 55% të emetimeve të gazeve serë në krahasim me nivelin e viteve 1990 arrin në 400-440 miliardë euro në vit midis 2021-2030. Në të njëjtën kohë, ne pranojmë se kuadri rregullator është ende në zhvillim dhe duhet të plotësohet ndjeshëm për të trajtuar më tej tranzicionin. Në këtë kontekst, është thelbësore që të sigurohemi që informacioni i duhur të jetë i disponueshëm dhe i kuptueshëm për investitorët për të marrë vendime të informuara, për të mbrojtur integritetin e tregut dhe besimin në sistemin tonë financiar dhe për të parandaluar rrezikun e greenwashing. ESMA ka punuar shumë me organizmat e tjerë evropianë dhe ligjvënësit evropianë dhe është angazhuar gjerësisht me palët e interesuara për të ofruar udhëzime mbi zbatimin e kuadrit ekzistues, dhe aty ku është e përshtatshme për të këshilluar se si të përmirësohen më tej dhe/ose plotësojnë atë.

Objektivi përfundimtar është të mbështetet kanalizimi i flukseve të nevojshme të kapitalit, për të përmbushur objektivat e BE-së për dekarbonizimin, si dhe objektivat e saj mjedisore dhe sociale. ESMA është e gatshme të kontribuojë në ndryshime të mëtejshme legjislative dhe ti përgjigjet zhvillimeve të reja të tregut.

Puna vijon dhe ESMA është plotësisht e mobilizuar për të luajtur rolin e saj dhe për të kontribuar në arritjen e synimeve ambicioze që BE i ka vendosur vetes në mbështetje të një tranzicioni efektiv dhe të rregullt drejt një ekonomie më të qëndrueshme.

IOSCO vendos standardin për rregullimin global të kriptove

Më 23 maj, IOSCO ka publikuar për konsultim, rekomandime të detajuara për juridiksionet anembanë globit se si të rregullojnë kripto-asetet dhe si duhet të mbrohen klientët dhe se si tregtimi i kriptove duhet të përmbushë standardet që zbatohen në tregjet publike.

Në deklaratën publike në faqen zyrtare të IOSCO-s Jean-Paul Servais, Kryetar i saj tha: "Siç na u soll në vëmendje nga deklarata e Ministrave të Financave të G7 dhe Bankës Qendrore në 13 maj, ka ardhur koha për t'i dhënë fund pasigurisë rregullatore që karakterizon aktivitetet e kriptove. Dokumenti i sotëm i konsultimit mori mbështetje unanime nga Bordi i IOSCO-s dhe është rezultat i një periudhe intensive të analizës së rrezikut rregullator, shkëmbimit të informacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve. Si i tillë, ai do të shënojë një pikë kthese në adresimin e rreziqeve shumë të qarta dhe të afërta për mbrojtjen e investitorëve dhe rreziqet e integritetit të tregut.

LIM Tuang Lee, Kryetar i Grupit të Punës për Fintech, i krijuar për të zhvilluar rekomandimet e politikave, tha: "Rekomandimet në Raportin e Konsultimeve të IOSCO-s vendosin pritshmëri dhe drejtimit kryesore për të rregulluar dhe mbikëqyrur tregjet e kripto-aseteve, të cilat në thelb janë veprimtari me natyrë ndërkufitare. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve duhet të trajtojnë konfliktet e papranueshme të interesit dhe të marrin shumë më seriozisht të drejtën e klientëve që paratë dhe asetet e tyre të trajtohen me kujdes. Është koha që rregullatorët të punojnë së bashku përtej kufijve dhe juridiksioneve të ndryshme për të siguruar që mbrojtja e investitorëve dhe integriteti i tregut të ruhen edhe në tregjet e kripto-aseteve."

Vijon ...



IOSCO vendos standardin për rregullimin global të kriptove

Informacionin e plotë e gjeni në <https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS693.pdf>

... vijon

Me 130 anëtarë në mbarë botën që rregullojnë më shumë se 95% të tregjeve botërore të letrave me vlerë, IOSCO është pozicionuar më së miri për të ofruar një grup rekomandimesh politikash efektive dhe të qëndrueshme globalisht. Mbështetja e fortë e Bordit të IOSCO-s do të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve nga të gjithë anëtarët e IOSCO-s për të kufizuar rrezikun e arbitrazhit rregullator.

IOSCO ka hapur një konsultim publik mbi rekomandimet e tij dhe synon t'i finalizojë deri në fund të vitit. Pas kësaj, ai pret që juridiksionet të rishikojnë kuadrin e tyre aktual rregullator për të siguruar që ato të jenë në përputhje me standardet dhe të rregullojnë menjëherë çdo boshllëk.

Komentet mbi dokumentin e konsultimit duhet të dërgohen në cryptoassetsconsultation@iosco.org deri më datë 31 korrik 2023.

KROACI

www.xprimm.com

Siguruesit kroatë po përgatiten të përballen me një ligj të ri mbi MTPL-në e detyrueshme. Aktualisht projektligji po kalon në proces debati publik, i cili duhet të përfundojë deri më 3 qershor. Pas kësaj ligji i ndryshuar do të dorëzohet në Qeveri, e më pas në Kuvend dhe pritet të hyjë në fuqi në vjeshtë.

Sipas osiguranje.hr, Shoqata Kroate e Industrisë së Automjeteve (HUAS) njofton se do të ketë “ndryshime tektonike” të cilat do të “përmbysin monoqet e kompanive të sigurimit”. HUAS theksoi se dispozitat e ligjit të ri parashikojnë që klientët e siguruesve të kenë të drejtën për të marrë një vlerësim dëmi jo vetëm nga siguruesi i tyre, por edhe nga subjekte të pavarura, teknike shërbimi të licencuar. Shoqata argumenton se numri i shlyerjeve për kërkesat është shumë i madh, gjë që çon në një numër të madh riparimesh jo të duhura dhe një ulje të përgjithshme të sigurisë së automjetit. “Thelbi i ligjit të ri është që si siguruesit ashtu edhe të siguruarit të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë në BE, që shmangia e TVSH-së të jetë e pamundur, të parandalohet zona gri dhe të parandalohet edhe ekzistenca e një numri të madh makinash me defekte teknike”, pohon HUAS.

Megjithatë, siguruesit nuk pajtohen me këtë mendim. Sipas Byrosë Kroate të Sigurimeve, ndryshimet në ligjin për sigurimin bazë të automjeteve kanë të bëjnë kryesisht me domosdoshmërinë e zbatimit të ndryshimeve në Direktivën për Sigurimin e Automjeteve, në lidhje me mbrojtjen e palëve të dëmtuara në rast të falimentimit ndërkufitar, certifikatat e ngjarjeve të padëshiruara, përkufizimet e reja të automjeteve dhe të ngjashme. “Është e rëndësishme të thuhet se sistemi i kompensimit të sigurimeve MTPL funksionon shumë mirë, domethënë çdo vit ne lidhim më shumë se tre milionë kontrata për sigurimin e përgjegjësive automobilistike dhe sigurimin gjithëpërfshirës dhe çdo vit shlyhen më shumë se 100 mijë dëmshpërblime dhe mbi 200 milionë euro paguhen vetëm në segmentin e MTPL-së, me një numër të papërfillshëm procesesh gjyqësore”, deklaroi drejtori i Byrosë Kroate të Sigurimeve, Hrvoje Paukovic. Ai theksoi se sistemi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore përmes zyrës së avokatisë së sigurimit dhe qendrës për pajtim pranë Byrosë Kroate të Sigurimeve mundëson zgjidhjen e lirë të mosmarrëveshjeve dhe kundërshtimeve të mundshme, kështu që numri i kërkesave ndaj siguruesve është mjaft i ulët.

“Ne jemi duke punuar për këtë ligj me palë të tjera të interesit dhe presim që propozuesi i ligjit, Ministria e Financave dhe rregullatori ynë HANFA, t’i marrin parasysh këto fakte gjatë hartimit të propozimeve përfundimtare për ligjin, si dhe aktet nënligjore. Gjithashtu presim që propozimet e caktuara për ndryshime të dërguara nga grupe të caktuara të interesit që kanë të bëjnë me automjetet do të njihen si propozime për promovimin e interesave të tyre të veçanta, e jo si propozime që synojnë mbrojtjen e konsumatorëve”, ka thënë Paukoviç për osiguranje.hr.

Vijon ...

KROACI

www.xprimm.com

... vijon

Tregu kroat i sigurimeve pati një dinamikë shumë modeste, por pozitive në tremujorin e parë të vitit 2023. Vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 1.5% krahasuar me vitin 2022, duke arritur në 411.16 milionë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës ra me pothuajse 30%, kryesisht për shkak të rënies së produkteve të sigurimit të Jetës të lidhura me skemat e investimeve.

Në sigurimet e Jo-Jetës, kontributin më të lartë në rritjen e primeve të shkruara bruto e kanë marrë linjat e sigurimit motorik, kryesisht klasa e sigurimeve të detyrueshme MTPL, e cila ka shënuar një rritje prej gati 21%, duke arritur në 116.6 milionë euro. Me një dinamikë të ngjashme, sigurimi Kasko kontribuoi në rritjen e primeve të shkruara bruto.

Me shumë pak përjashtime, shumica e klasave sigurimeve të Jo-Jetës kanë pasur evolucion pozitiv në krahasim me tremujorin e parë 2021.

Në përgjithësi, në tregun kroat të sigurimeve, dëmet e paguara u rritën me 13.8%, me një dinamikë të ngjashme si në sigurimin e Jetës ashtu edhe Jo- Jetës. Inflacioni pati shume ndikim si në primet e shkruara ashtu edhe në vlerën e dëmeve të paguara. Sigurimi tradicional i Jetës dhe sigurimet e detyrueshme MTPL dhe në një masë më të vogël sigurimi Kasko ishin linjat e biznesit që shënuan rritjet më të rëndësishme të dëmeve të paguara.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, ISA, biznesi i siguruesve malazezë u rrit me 13.83% në vit në tremujorin e parë të 2023, duke arritur në 30.61 milionë euro.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës arritën në 25.83 milionë euro në periudhën janar-mars 2023, me 14.78% më shumë se një vit më parë. Ndërsa primet e sigurimit të Jetës arriti në 4.78 milionë euro, duke u rritur me 2.79%.

Në të njëjtën kohë, totali i dëmeve të paguara bruto u rrit me 13.09% duke arritur në 11.90 milionë euro. Nga ky total, dëmet për sigurimet e Jetës arritën në 2.79 milionë euro, me rritje 13.27% në tremujorin e parë 2023 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa pagesat e sigurimeve të Jo-Jetës u rritën me 13.04%, duke arritur në 9.11 milionë euro.

Statistikat e publikuara nga ISA malazeze përfshijnë të dhëna nga nëntë kompani sigurimesh që operojnë në vend: katër sigurues të Jetës dhe pesë sigurues të Jo-Jetës.

RUMANI

www.xprimm.com

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në fund të vitit 2022 arriti vlerën e 3.34 miliardë euro, pothuajse 16% më shumë krahasuar me një vit më parë. Tregu i sigurimeve të Jetës pati një rritje shumë të ngadaltë me vetëm 1.45% krahasuar me vitin 2021, ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës regjistroi një rritje me rreth 20%, duke arritur në 2.8 miliardë euro. Kontributin më të lartë në rritjen e sektorit të sigurimeve të Jo-Jetës e ka ardhur nga sigurimet motorike, veçanërisht nga klasa e sigurimit të detyrueshëm MTPL, e cila ka siguruar 67% të primeve të shkruara shtesë në krahasim me vitin 2021.

Dëmet e paguara u rritën mesatarisht me 2.3% në terma vjetorë, duke arritur vlerën e 1.27 miliardë euro në total. Vlen të theksohet se në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, totali i dëmeve të paguara shënoi një rënie vjetore me 2.4%, ndërsa në sigurimin e detyrueshëm MTPL, rënia ishte gati 6% pavarësisht sfidave të ngritura nga inflacioni. Megjithatë, nuk duhet harruar se kësaj shifre do t'i shtohen edhe pagesat për dëmet e MTPL-së me vlerë rreth 132 milionë euro që do të paguheshin nga Fondi i Garancisë.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundvitit të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, NBS, tregu serb i sigurimeve e mbylli vitin 2022 me një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 134 miliardë RSD ose rreth 1.14 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 12.16% krahasuar me vitin 2021.

Ndërkaq vlera e përgjithshme e dëmeve të paguara për periudhën janar-dhjetor 2022 arriti në 65.35 miliardë RSD ose rreth 557 milionë euro. Duke shënuar një rritje prej 21.66% në vit, nga të cilat dy nënklasat e sigurimeve motorike, MTPL dhe Sigurimi Kasko, të marrë së bashku, gjeneruan 38% të totalit të dëmeve.

Sigurimet e Jo-Jetës përbënin 78.57% të totalit të primeve të shkruara bruto, me vlerë rreth 105.22 miliardë RSD, duke shënuar rritje me 14% krahasuar me vitin 2021. Në vëllimin e primeve të shkruara bruto, 53 miliardë RSD lidhen me klasat motorike dhe 26.62 miliardë RSD me sigurimin e pronës. Sigurimet e Jetës zinin 21.43% ose rreth 28.70 miliardë RSD, duke u rritur vetëm 5.88% krahasuar me vitin 2021.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al